



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 nëntor 2015
Nr. ref.:RK 853/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI38/15

Parashtrues

Kolë Puka

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, PML.-KZZ. nr. 170/2014, të 19 shkurtit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Kolë Puka aktualisht në vuajtje të dënimit me burg në burgun e Dubravës, të cilin e përfaqëson djali i tij z. Driton Puka nga fshati Renoc, komuna e Klinës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.-KZZ. nr. 170/2014, të 19 shkurtit 2015, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 2 mars 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, për të cilin, parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), sipas nenit 31, pika 1.3 dhe 5 (E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 mars 2015, përfaqësuesi i parashtruesit e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 22 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI38/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 1 korrik 2015, nga vendimi i Kryetares së Gjykatës, gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi ishte caktuar si anëtare e Kolegjit shqyrtues, duke zëvendësuar Kadri Kryeziun, të cilit i përfundoi mandati i gjyqtarit më 26 qershor 2015.
8. Më 29 korrik 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Me 11 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 24 maj 2012, parashtruesi i kërkesës si njëri nga 4 (katër) të akuzuarit me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 477/11, është shpallur fajtor për veprën penale “të shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autoritetit” dhe me këtë rast, atij i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh, njëkohësisht, me këtë Aktgjykim, i është shqiptuar edhe dënimi plotësues “ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik” në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh.

11. Gjykata e Qarkut si gjykatë e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit, ndërmjet të tjerash, ka theksuar se ishte dëshmuar se ndërmjet 12 shtatorit 2007 dhe 8 prillit 2008, në Klinë, parashtruesi, në cilësinë e gjykatësit të Gjykatës Komunale, së bashku me një avokat nga Klina, kanë sajuar dhe kanë ekzekutuar një plan për të ngritur një parashtrësë për kompensim të dëmit të shkaktuar në një aksident komunikacioni pa dijeninë e personit të dëmtuar. Pastaj, parashtruesi, si gjyqtar duke kryer detyrën zyrtare, lëshoi vendim gjyqësor që ka vendosur të caktojë kompensimin material të një personi të caktuar pa asnjë dëshmi për të mbështetur këtë çmim të kompensimit në dëm të fondit të garancisë së sigurimeve.
12. Më 15 korrik 2012, parashtruesi ka ushtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë të përmendur si më lart.
13. Më 25 prill 2013, Gjykata e Apelit ka nxjerrë Aktgjykimin PAKR 1122/2012, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit, ndërsa sipas detyrës zyrtare pjesën e aktgjykimit që kishte të bëjë me parashtruesin, e ka modifikuar duke e ricilësuar veprën penale. Ashtu që në vend të veprës penale *“Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autoriteti”* parashtruesi ishte shpallur fajtor për veprën penale të *“Nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm gjyqësor”* Gjykata e Apelit pastaj i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje të njëjtë kohore sikur edhe Gjykata e Qarkut në Pejë, por duke e përdorur ligjin më të favorshëm për parashtruesin atij i ka hequr dënimin plotësues të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.
14. Gjykata e Apelit e ka arsyetuar aktgjykimin si vijon: *“Sipas mendimit të Kolegjit të Apelit, i kundërt me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, krahasimi i elementeve ligjore të veprave penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit dhe nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore qojnë në konkluzionin se ky i fundit është krim-më specifik që përfshin veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit me zbatimin e parimit lex specialis derogate lex generali”*.
15. Gjykata, më tej, ka arsyetuar se *“Ky keqaplikim i Ligjit penal nga trupi gjyqësor është në dëm të të akuzuarit sepse ka mundur të ketë ndikim në caktimin e dënimit pasi që të dy dispozitat penale parashohin dënime të ndryshme: për veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit parashihet dënimi prej një deri në tetë vjet burgim, ndërsa për veprën penale të nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, parashihet dënimi prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim. Dhe “Për këto arsye Kolegji i apelit modifikon Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të akuzuarin Kolë Puka e shpall fajtor për veprën penale të nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”*.
16. Më 4 shkurt 2014, parashtruesi paraqiti një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.
17. Më 19 shkurt 2015, Gjykata Supreme vendosi sipas kërkesës së parashtruesit dhe pas marrjes së mendimit nga zyra e Kryeprokurorit të Shtetit nxori Aktgjykimin, PML.-KZZ. nr. 170/2014. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur nga parashtruesi, është gjetur si pjesërisht e bazuar, ashtu që aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të Apelit ndryshohen sa i përket

sanksionit penal, në atë mënyrë që parashtruesi, dënohet me 6 (gjashtë) muaj më pak vuajtje të dënimit me burg.

18. Gjykata Supreme ndryshimin e aktgjykimit, e kishte bazuar kryesisht, në vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për parashtruesin nga ana e gjykatave të rregullta, dhe me at rast, ndërmjet të tjerash ka arsyetuar: *"Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje të Ligjit penal gjatë shqiptimit të dënimit maksimal të aplikueshëm për veprën penale duke nxjerrë vendimin gjyqësor të kundërligjshëm. Sipas nenit 438 paragrafit 1 nën-paragrafit 1.1 Gjykata Supreme, duke u pajtuar me të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të përmendura në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndryshon aktgjykimin dhe përcakton se dënimi prej 4 (katër) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj është proporcional".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Kosovës për Gjykim të drejtë dhe Gjykim të Paanshëm (neni 31 i Kushtetutës), rasti i tij penal kishte qenë i ndarë në 5 (pesë) raste penale edhe pse të gjitha rastet ishin për të njëjtën çështje. Parashtruesi i kërkesës pretendon se procedura rezulton shkeljen e nenit 31.5 të Kushtetutës, që i referohet prezumimit të pafajësisë.
20. Parashtruesi më tej, ka pretenduar, se përbërja e panelit gjyqësor në Gjykatën Supreme nuk ka qenë e përcaktuar në përputhje me Ligjin për kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, Nr. 03/L-053.
21. Parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata që të anulojë të gjitha aktgjykimet e gjykatave të rregullta dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:
"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".
24. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese që përcakton:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".

25. Gjykata vë në dukje se parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31.1, 2 dhe 3 të Kushtetutës.
26. Gjykata me këtë rast përkujton se Kushtetuta e Kosovës, në dispozitat e kontestuara nga parashtruesi përcakton:

Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm, lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

27. Për të vendosur në mënyrë meritore lidhur me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh dispozitat e Ligjit për gjykatat 2010/03-L-199, të dekretuar më 9 gusht 2010, ku është përcaktuar:

Neni 21 Gjykata Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka jurisdikcion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

[...]

dhe

Neni 22 Kompetencat e Gjykatës Supreme

1.3. përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës;

[...]

28. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në prizmën e pretendimeve për shkelje kushtetuese, dhe fakteve që kanë mbështetur këto pretendime, duke i krahasuar këto fakte me përmbajtjen e dispozitave si më lart Gjykata konstaton, se nuk gjen argumente të kenë ndodhur shkelje të dispozitave kushtetuese aq më tepër, kur këto pretendime kanë qenë të karakterit thjesht ligjor dhe jokushtetues, dhe se Gjykata jep përgjigje efektive

ndaj këtyre pohimeve. Kjo Gjykatë nuk mund të veprojë si Gjykatë e shkallës së katërt duke respektuar interpretimin e saktë të ligjit.

29. Gjykata rikujton se parashtruesi beson se ndarja e një rasti penal në disa të tjerë sipas tij rezulton me shkelje substanciale të procedurës penale, Ligjit penal dhe të të drejtave të pandehurit, por që këtë pohim Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj në paragrafin 60 e ka refuzuar si të pabazuar.
30. Lidhur me pretendimin për përbërjen joligjore të panelit gjyqësor të Gjykatës Supreme, që ka vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata thekson se kjo çështje ka të bëjë me aplikimin e drejtë të ligjit, e që është kompetencë ekskluzive e gjykatave të rregullta.
31. Për më tepër, vet Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, në paragrafët 50-57 në mënyrë ekstensive dhe bindëse ka shpjeguar kompozicionin e panelit gjyqësor duke marrë parasysh të gjitha aktet juridike vendore, Marrëveshjen Ndërkombëtare me Misionin e Bashkimit Evropian të ratifikuar me Ligjin, 04 L-274, të shpallur nga Presidentja më 7 maj 2014, dhe Konventën e Vjenës.
32. Për t'u trajtuar si çështje kushtetuese në relacion me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), kompozicioni i panelit gjyqësor do të duhej të ishte tregues i qartë i anshmërisë në gjykim. Por në këtë rast anshmëria e Kolegjit gjyqësor, as është kontestuar e as është dëshmuar nga parashtruesi andaj në këto rrethana nuk ka ndonjë dëshmi se mund të konstatohet shkelje e nenit 31 të Kushtetutës apo nenit 6 të KEDNJ-së.
33. Gjykata thekson se përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe pretendimi, se ato janë shkelur pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat e shkeljeve të pretenduara, ose, pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së, lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm.
34. Gjykata më tej konstaton se aktgjykimet e gjykatave të rregullta të cilat i konteston parashtruesi, në respektimin substancial të të drejtave të njeriut duke i ofruar të gjitha mundësitë procedurale e përmbajtjesore parashtruesit, të jetë palë e barabartë dhe aktive në të gjitha fazat e procesit gjyqësor. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit në mënyrë specifike mbështetet mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të gjykatave të tjera ndërkombëtare, si dhe raste nga praktika gjyqësore vendore duke shqyrtuar ankesën e parashtruesit.
35. Si përfundim, Gjykata thekson se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjeshtë një instancë gjyqësore më tepër. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të së drejtave kushtetuese, dhe jo çështjet qartazi ligjore. (Shih, *mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65). Në këtë rast, parashtruesi kryesisht ka paraqitur pretendimet për shkeljet ligjore, jo shkeljet kushtetuese.

36. Gjkata thekson se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të rregullt të vendosin për renditjen e rëndësisë së provave, dhe të çmojnë se cila provë në vështrim të zbatimit të drejtë të ligjit në fuqi mbizotëron. Në rastin konkret padyshim, se i ka takuar Gjykatës Supreme të vendosë sa është i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë apo i asaj të Apelit, dhe këtë ta sanksionojë me vendim të saj përfundimtar gjyqësor.
37. Duhet të theksohet se Kushtetuta e Kosovës në nenin 103.2 ka përcaktuar se Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor, ndërsa ligji për gjykatat, Gjykatës Supreme i ka dhënë kompetencë “*zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës*” dhe rrjedhimisht, edhe unifikimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta.
38. Në këtë drejtim, Gjykata nuk gjen se arsyetimet e ndryshme të gjykatave të dy instancave gjyqësore kanë rezultuar me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, sepse Aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës Supreme ka përmbyllur vlerësimin edhe të gjendjes faktike edhe të aplikimit të ligjshmërisë, dhe në asnjë mënyrë parashtruesi nuk ka provuar që Aktgjykimi i kontestuar të jetë tregues i ndonjë arbitrariteti të dukshëm që kërkon anulimin e tij në baza kushtetuese.
39. Në këto rrethana të rastit, Gjykata nuk ka mundur të gjejë se është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Shih gjithashtu Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, Rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha*, në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).
40. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e tij të drejtë kushtetuese apo të të drejtave të garantuara me KEDNJ, andaj me vendimin e kontestuar nuk ka shkelur të drejtat e njeriut të parashtruesit. Prandaj, Gjykata gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 48 të Ligjit, dhe me rregullat 36.1 (c), 36 (2) b) dhe d) si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi